


# ZEMRAT TONA



# RRAHIN NJËLLOJ

## NE DHE DEMOKRACIA

ADISA (11), EGZONA (12), RAMADAN (12), GENTRIT (11), ENDRITA (12), BLEONA (11)



### Demokracia nuk është vetëm më i bukuri emër. Por, është edhe sistemi më i dashur i qeverisjes

Grupi i demokratëve sot ka marrë shumë informata për sistemin më të mirë të qeverisjes, që është demokracia. Kur edukatorja na tha që demokracia është sistemi më i mirë dhe më i dashur i qeverisjes, shoqja jonë Bleona mbeti e habitur. Ajo kërkoi nga edukatorja që të na tregonte në mënyrë më konkrete për këtë sistem. Edukatorja filloi kështu: „Demokracia është sistem ku të gjithë qytetarët janë të barabartë me njëri-tjetrin. Në asnjë mënyrë nuk ka qytetarë të cilët gëzojnë më shumë të drejta sesa qytetarët e tjerë“. Këtë ne e vërtetuan në grupin e vogël, sepse të gjithë u trajtuam në mënyrë të barabartë dhe mendimet e secilit prej nesh u vlerësuan dhe u respektuan. Kur edukatorja në fillim bëri disa pyetje se çka do të thotë demokracia për ne dhe nga cila fjalë rrjedh, shumica prej nesh e dinim. Mirëpo, edukatorja dëshironte që të gjithë të merrnim pjesë në diskutim. Qoftë edhe nëse ndonjëri nuk ishte i/e sigurt rreth përgjigjes së saktë. Kjo është demokracia, kur të gjithë mund të shprehemi lirshëm dhe mendimi ynë është i mirëpritur dhe i respektuar nga të tjerët.

„Demokraci është edhe liria për të zgjedhur lirshëm profesionin që qytetarëve iu pëlqen më së shumti“, tha shoku Ramadan. Ai njuh një vajzë, e cila kishte ëndërruar që të bëhej infermiere dhe dëshirën e saj ajo e ka realizuar së fundmi. Pra, për këtë demokracia është më i miri sistem. Por, përveç këtyre që i cekëm më lart, demokracia është sistemi më i dashur, sepse vetë kuptimi i fjalës demokraci është udhëheqje e po-


pullit. E pa dyshim që kjo e fuqizon edhe më shumë rëndësinë e saj në jetën tonë. Në vendin tonë, ne kemi demokraci përfaqësuese. Qytetarët mbi moshën 18 vjeçare i zgjedhin përfaqësuesit e tyre, të cilët ne i njohim si deputetë. Përpos këtij lloji të demokracisë, kemi edhe demokracinë e drejtpërdrejtë. Në këtë lloj të demokracisë, vendimet merren direkt nga ana e popullit. Ndërsa, te demokracia përfaqësuese, janë deputetët, ata të cilët marrin vendime për popullin. Pra, në demokraci, si në atë të drejtpërdrejtë, ashtu edhe në atë përfaqësuese, janë qytetarët ata të cilët luajnë rolin kryesor. Shteti është i zhvilluar nëse çdo qytetar është i /e lumtur nga shteti i tij/saj. Ne e jetuam sot demokracinë, në çdo minutë që kalonte. Prandaj, jemi shumë të lumtur që patëm mundësi të tregojmë veten, përmes vizatimeve, shkrimeve, ideve, etj. Unë dhe grupi ynë ju falenderojmë për vëmendjen tuaj të dashur lexues. Paçi gëzime edhe ju, ashtu siç u gëzuam ne sot!



Demokratët e rinjë

# PERSONAT QË MË PËRFAQËSOJNË MUA DHE TY

ARBULENA (12), HAMIDE (10), ELONA (11), RIAD (11), ERDONIT (11), FATLIND (12)



**Ne jemi një grup i nxënësve, të cilët kemi mësuar për Kuvendin. Ne kemi menduar se edhe ju të dashur fëmijë do të dëshironi të mësoni për këtë temë. Prandaj, kemi përgatitur këtë artikull kaq të bukur për ju**

Të dashur lexues, mirësevini në artikullin tonë. A dëshironi të mësoni për Kuvendin? Ne do të flasim pikërisht për këtë temë. Kuvendi i Kosovës ka 120 deputetë. Prej tyre më shumë ka shqiptarë. Gjithsej janë 100 deputetë shqiptarë. Ndërsa, të tjerë janë deputetë

më të pjekur dhe kanë mundësi të marrin më shumë përgjegjësi për zgjedhjet e tyre. Vlen të theksohet se me rregull, zgjedhjet në Kosovë ndodhin çdo 4 vjet. Pasi deputetët e marrin postin e ri, ata kanë disa detyra. Detyra e përfaqësimit është detyrë shumë e rëndësishme, sepse deputetët përfaqësojnë qytetarët. Detyra tjetër është bërja e ligjeve dhe vënia në funksion e tyre. Kjo do të thotë se të gjitha ligjet e Kosovës kanë ardhur nga deputetët e Kuvendit të Kosovës. Detyra e fundit është ajo e mbikëqyrjes së Qeverisë. Kuvendi kontrollon punën e Qeverisë, nëse ky institucion po i vë ligjet në zbatim.

Ligjet që dalin nga Kuvendi janë të ngjajshme me rregullat që kemi ne. Ne kemi shumë rregulla. Ato ekzistojnë në dyqan, në farmaci, në punë, etj. Ne kemi rregulla edhe për mbrojtjen e mjedisit, rregullat e sportit, rregullat e shkollës e plot të tjera. Të gjitha këto janë të respektuara dhe të zbatuara nga ne, sepse ne jemi qytetarë të denjë të demokracisë.



nga komunitetet jo shumicë. 10 deputetë janë serbë dhe 10 të tjerë të janë: turq, ashkalinjë, boshnjakë, egjiptianë, goranë dhe romë.

Nga kjo kuptojmë se këta deputetë nuk kanë prejardhje të njëjtë. Ata nuk flasin as gjuhën e njëjtë. Megjithatë, të gjithë kanë një gjë të përbashkët. Ata janë të zgjedhur nga qytetarët e Kosovës. Për të votuar, qytetarët duhen të kenë arritur moshën 18 vjeçare. Përse është caktuar kjo moshë? Sepse personat më të rritur janë



**Puna jonë respektohet dhe do të lexohet edhe nga të tjerët**






Piktorja gjatë punës. E përqendruar dhe aspak e lodhur. Të gjithë gazetarët e mirë duhet të jenë të tillë




Si fëmijë dhe si qytetar i Kosovës mua më takon kjo e drejtë. Megjithatë, mua më takojnë edhe të drejta të tjera



E duam demokracinë me gjithë zemër. Falë saj ne jetojmë në paqe dhe në harmoni me njëri-tjetrin



Mesazhi ynë për ditën e sotme: trajtoj të tjerët, ashtu si dëshiron që të tjerët të të trajtojnë ty



Këto elemente në fakt jemi ne, që të gjithë. Sa bukur apo jo?



Unë iu përfaqësoj të gjithë juve. Flas në emrin tuaj dhe përpiqem t'ua rregulloj jetët tuaja

## BËHU AKTIV


AGNESA (11), ANITA (11), RIAD (10), FATJON (11), ARBULENA (11), ARDINIT (11)



### Ne si fëmijë në demokraci kemi shumë të drejta dhe jemi të lumtur që jetojmë në një vend të tillë

Barazia, element ky shumë i rëndësishëm në demokraci. Pasi që ne jetojmë në një vend demokratik, të gjithë i kemi të drejtat e barabarta. Për ta kuptuar më mirë rëndësinë e të drejtave tona, në vijim do ta tregojmë një shembull.


Ardiana është një gazetare shumë e suksesshme dhe mjaft e njohur në vendin e saj. Kur ajo ishte nxënëse



jemi të përgjegjshëm për veprimet tona.

Ne si fëmijë mund të jemi qytetarë aktiv duke pastruar mbeturina, duke mbrojtur mjedisin, duke respektuar dhe ndihmuar të moshuarit, duke respektuar rregullat e komunikacionit, etj.

Demokracia pa qytetari aktive është e mangët. Prandaj, mesazhi ynë për ju është: të bëhemi qytetarë sa më aktiv në vendin tonë!



në shkollën fillore, kishte mësuar shumë dhe ishte zgjedhur si nxënësi më e dalluar e shkollës. Pra, ajo e ka pasur të drejtën e shkollimit dhe e ka shfrytëzuar atë duke qenë e përgjegjshme dhe duke mësuar shumë. Po ashtu, Ardiana ka qenë shumë aktive edhe në komunitetin e saj, duke marrë pjesë në organizata të ndryshme jo qeveritare.

Nga shembulli i përmendur mund të kuptojmë se përveç të drejtave që i kemi në demokraci, ne duhet të



Grupi „Nxënësit Aktiv“





## IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI  
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA  
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



**ERSTE Stiftung**

Redaktohet nga  
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit  
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga  
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:  
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Afrim Krasniqi“  
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: VI-1  
Website: www.demos-ti.org Vendi: Bardh, Malishevë